



RREGULLORE NR. 2005/5
PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI LOJËRAT E FATIT TË MIRATUAR NGA
KUVENDI I KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me kapitullin 8 dhe nenet 9.1.44 e 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 28 qershor 2004 lidhur me Ligjin mbi lojërat e fatit të miratuar nga Kuvendi më 8 shtator 2004,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo me pushtetin e tij të rezervuar dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi lojërat e fatit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/35), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që shprehja “Dispozitat penale” në titullin e kapitullit VII të fshihen dhe të zëvendësohen me “Sanksionet administrative” dhe fjala “i penalizuar” në nenin 59.2 të fshihet dhe të zëvendësohet me “i gjobitur”. Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

E nënshkruar sot, më 3 shkurt 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm